

AUTORITETI I ÇERTIFIKIMIT

KODI I ETIKËS I FNK-të, SNKC-të, SNA-të, DIREKTIVAT E PRAKTIKAVE NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT, SNAR-të, SNAS-të DHE STANDARDEVE TË TJERA TË PUBLIKUARA NGA FNK, SI DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË PROFESIONIT TË EKR-të

SEKSIONI I : Pyetje me alternativa (1 PIKË SECILA)

1. Sipas Kodit të Etikës për EKR, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimeve të identifikuara dhe nëse ato janë të rëndësishme, ai duhet të:

- a) diskutojë çështjen me nivelet e larta të drejtimit brenda firmës
- b) diskutojë çështjen me personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit
- c) tërhiqet nga grupi i angazhimit.
- d) të gjitha alternativat e mësipërme
- e) asnjëra

Pergjigja e sakte alternativa D

2. E drejta për të kryer shërbimin e auditimit ligjor, për një ekspert kontabël të regjistruar apo për një shoqëri audituese, mund të hiqet nga;

- a) IEKA
- b) Bordi i Mbikëqyrjes Publike të ekspertëve kontabël të regjistruar
- c) Keshilli Drejtues
- d) Drejtori Ekzekutiv i IEKA-s
- e) Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve

Pergjigja e sakte alternativa B

3. Ortaku i angazhimit duhet të:

- a) Jetë përgjegjës për grupin e angazhimit duke kryer për këtë qëllim konsultimet e duhura për çështje të rëndësishme ose të diskutueshme;
- b) Bindet që anëtarët e grupit të angazhimit kanë bërë konsultimet e duhura gjatë kryerjes së angazhimit, si brenda grupit të angazhimit ashtu edhe midis grupeve të angazhimit dhe të tjerëve në nivelet e duhura brenda e jashtë firmës;
- c) Bindet që natyra, objekti dhe konkluzionet e arritura nga këto konsultime janë dokumentuar e pranuar nga pala e konsultuar; dhe
- d) Bëjë të mundur zbatimin e konkluzioneve që rrjedhin nga konsultimet.

Pergjigja e sakte alternativa A, B, C

4. Si pjesë e njohjes së entitetit dhe të mjedisit të tij audituesi duhet të sigurojë një njohje të përgjithshme për:

- a) Kuadrin ligjor dhe rregullat të cilave i nënshtrohet entiteti dhe sektori në të cilin ai vepron; dhe
- b) Mënyrën se si entiteti e respekton këtë kuadër.
- c) Cdo papajtueshmëri të ndodhur gjatë vitit financiar që po auditon

Pergjigja e sakte alternativa A, B

5. Përpara se të nisë një auditim për herë të parë, audituesi duhet të realizojë cilin nga aktivitetet në vijim?

- a) Të komunikojë me Institutin e ekspertëve kontabël të autorizuar.
- b) Të komunikojë me klientin.
- c) Të komunikojë me audituesin e mëparshëm.
- d) Të komunikojë me Ministrinë e Financave.

Pergjigja e sakte alternativa C

6. Në cilat raste e rishikon audituesi materialitetin e pasqyrave financiare?

- a) Kur identifikon anomali materiale dhe vendos të rrisë nivelin e materialitetit në mënyrë që anomalitë materiale të mos ndikojnë në raportin e audituesit
- b) Kur identifikon informacion i cili ndikon shumat dhe mënyrën e përlogaritjes së materialitetit
- c) Kur drejtuesit e entitetit e kërkojnë një gjë të tillë
- d) Kur IEKA ka miratuar një ndryshim në mënyrën e përlogaritjes së materialitetit

Pergjigja e sakte alternativa B

7. Neqofte se gjatë procesit të auditimit, audituesi nuk pengohet nga drejtimi i njësisë ekonomike në marrjen e informacionit që do t'i nevojitet në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë dhe zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe konstaton që nuk ka as gabime materiale dhe as gjithëpërfshirëse atëherë audituesi duhet të lëshojë një opinion?

- a) Opinion me rezerva
- b) Opinion të kundërt
- c) Opinion standard
- d) Audituesi duhet të shprehe opinion me rezerve ose të refuzojë dhenien e opinionit

Pergjigja e sakte alternativa C

8. Audituesi konstaton gabime materiale mes informacionit “tjetër” të një Shoqërie dhe informacionit të pasqyruar në pasqyrat financiare. Si duhet të veprojë audituesi në këtë rast?

- a) Flasë me drejtimin dhe të arrijë në një marrëveshje për të rregulluar/korrigjuar anomalinë
- b) Flasë me drejtimin dhe të arrijë në një marrëveshje për të rregulluar/korrigjuar anomalinë dhe të lëshojë një opinion të pamodifikuar

- c) Flasë me drejtimin dhe të arrijë në një marrëveshje për të rregulluar/korrigjuar anomalinë dhe të lëshojë një opinion të modifikuar
- d) Të mos lëshojë opinion

Pergjigja e sakte alternativa A

9. Konfirmimet negative *nuk* përdoren në rastet e mëposhtme;

- a) Risku i gabimeve materiale është i lartë;
- b) Audituesi nuk pret që marrësit e konfirmimeve negative të kenë diferenca në konfirmim;
- c) Popullata përbëhet nga një numër i madh balancash homogjene dhe të vogla;
- d) Numri i devijimeve pritet të jetë i vogël

Pergjigja e sakte alternativa A

10. Cfarë nuk kërkon SNA 600 që të dokumentojë audituesi i grupit

- a) Një analizë të komponentëve;
- b) Natyrën, kohën dhe sa e detajuar ka qënë përfshirja e audituesit të grupit në punën e komponentit;
- c) Komunikimet e shkruara mes audituesit të grupit dhe audituesit të komponentit;
- d) Komunikimet lokale mes audituesit të komponentit dhe klientit

Pergjigja e sakte alternativa D

SEKSIONI II: Organizimi i Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar

1. Cekoni me Po ose Jo se cilat nga te meposhtmet jane të drejta dhe detyra qe ka Bordi i Mbikqyrjes Publike të EKR-ve; (**5 pike**)

Të mbikqyrë kontrollin e cilësisë që realizohet nga organizata profesionale e EKR-ve	PO
Të miratojë rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore	PO
Të hartojë, të miratojë dhe të mbikëqyr kodin e etikës të ekspertëve kontabël e të shoqërive audituese.	JO
Të miratojë dhe të mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të ekspertëve kontabël;	JO
Të miratojë Statutin e IEKA-s.	JO

2. Tregoni shkurtimisht disa masa disiplinore për ekspertët kontabël dhe shoqëritë e auditimit, te parashikuara ne nenin 56 te ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të EKR-ve ...”,. (4 pike)

Pergjigje:

1. Masat disiplinore për ekspertët kontabël dhe shoqëritë e auditimit janë:
- a) këshillimi;
 - b) qortimi;
 - c) vërejtja me shënim në regjistrin publik;
 - ç) gjobat;
 - d) pezullimi i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vjet;
 - dh) fshirja e përhershme nga regjistri publik, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.

SEKSIONI III: Etika Profesionale

1. Ekzistojne disa rrethana qe mund të ndodhë që respektimi i parimeve themelore të kërcënohet nga veterishikimi. Tregoni duke cekuar ne kutine perkatese se cilat jan ato mbeshetur ne Kodin e Etikes se IEKA-s **(4 pike)**

Një anëtar i një grupi të angazhimit ka një marrëdhënie familjare të drejtëpërdrejtë ose të afërt me një drejtor apo nëpunës të klientit.		Jo
Një ish partner i firmës ka qënë drejtor, nëpunës, apo një i punësuar i klientit në një pozicion ku ka ushtruar influencë direkte dhe të rëndësishme mbi çështjen në fjalë të angazhimit.		Jo
Një anëtar i grupit të angazhimit është, ose kohët e fundit ka qënë, i punësuar tek një klient në një pozicion me influencë direkte e të rëndësishme mbi çështjen në fjalë që është objekt i angazhimit	Po	
Përfaqësimi nga eksperti kontabël në rolin e avokatit, në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, ose të mosmarrëveshjeve me palët e treta, në emër të një klienti në të cilin ai kryen një angazhim të dhënies së sigurisë.		Jo
Një anëtar i grupit të angazhimit është, ose kohët e fundit ka qënë një nga drejtorët apo nëpunësit e klientit, të cilit i jepet shërbimi.	Po	

2. Nje ekspert kontabel i autorizuar thirret per te zevendesuar nje kolegun e tij per kryerjen e angazhimit te auditimit te pasqyrave financiare te vitit 20xx te nje klienti, i cili nga forma e organizimit eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (shpk). Audituesi i meparshem kishte lidhur me kete klient nje kontrate nje vjecare dhe e ka perfunduar auditimin e i ka marre honoraret qe i takonin. **(5 pike)**

Pyetjet:

A duhet ta pranoje angazhimin audituesi i ri - jepni argumentet pro e kunder.

Cilat masa mbrojtese e kujdesi duhet te ndermarre audituesi i ri ne zbatim te kodit te etikes?

Pergjigje:

Audituesi i ri i cili thirret per zevendesimin e kolegut te tij, pasi merr njoftimin fillimisht duhet te paraqitet per kete thirrje. Me pas ai duhet te informohet ne lidhje me misionin qe do ti caktohet dhe ne momentin qe duhet te vendose nese duhet ta pranoje apo jo. Duhet patur kujdes sepse marredheniet qe mund te ndeshen nga profesionisti kontabel mund te krijojne kercenime ndaj respektimit te parimeve themelore.

Gjithashtu ne mbeshtetje te Ligjit nr 10091 neni 34 pika 4 cileson “

Eksperti kontabël ose shoqëria audituese, që ka ndërprerë angazhimet në një auditim të caktuar, ose **një ish-ekspert kontabël ose ish-shoqëri audituese**, do të vazhdojnë t’u nënshtrohen dispozitave të pikave 1 e 2 të këtij neni, në lidhje me auditimet e kryera. “

Pronarët, ortakët ose aksionarët e një shoqërie audituese, si dhe anëtarët e organeve të drejtimit apo administrimit të kësaj shoqërie ose të një shoqërie të lidhur me të, nuk lejohen të ndërhyjnë në kryerjen e një auditimi në çdo lloj mënyre, që rrezikon pavarësinë dhe objektivitetin e ekspertit kontabël, që kryen auditimin. Nderkohe emerimi i eksperteve duhet te behet ne perputhje me nenin 42 te po ketij ligji.

Per sa me siper para se të hyjë në funksion, për kryerjen e një angazhimi të auditimit të pasqyrave financiare, një ekspert kontabël i autorizuar duhet të këtë marrë nga klienti një dokument që përlligj pagimin nga klienti të honorareve për paraardhësit të tij, kur ato janë bazuar në një marrëveshje qartësisht të përcaktuar, ose kur i përgjigjen tabelës së hartuar nga instituti për punimet e kryera, dhe kur zbatimi i këtyre punimeve nga paraardhësit nuk ka qënë kundërshtuar nga klienti.

Nëqoftëse nuk është kështu, ai mund të fillojë funksionin e tij, pasi t’i ketë referuar çështjen presidentit të institutit dhe të ketë shfaqur rezervat e nevojshme pranë klientit të tij.

SEKSIONI IV: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, SNAR, SNSL, SNAS

1. Diskuto ne lidhje me pergjegjesine e audituesit per te zbuluar dhe raportuar mashtrimin sipas ISA 240 ne nje shoqeri me nje pronar. (4 pike)

Pergjigje:

Audituesi i cili kryen auditimin sipas SNA-ve eshte pergjegjes per te marre siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare ne teresi nuk permbajne anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi. Si rrjedhoje e kufizimeve natyrore te nje auditimi, gjithmone ekziston nje rrezik i pashmangshem qe disa anomali materiale te pasqyrave financiare te mos zbulohen edhe pse auditimi mund te jete planifikuar dhe zbatuar ne menyre korrekte dhe sipas SNA-ve. Reziku i moszbulimit eshte me i madh ne rastin e mashtrimit sesa ne rastin e gabimit. Kjo sepse mashtrimi mund te behet me metoda te sofistikuara, eshte planifikuar mire mbulimi i mashtrimit, nuk jepet informacion apo ka disa pale te rena dakord per te fshehur problematiken. Gjithashtu, reziku i moszbulimit behet me i madh nese manaxhimi eshte perfshire ne skemen mashtruese ne krahasim me rastin kur mashtrimi behet vetem nga individe punonjes. Pegjate mbledhjes se evidences, audituesi eshte pergjegjes per te ruajtur nje nivel te larte te skepticizmit profesional duke bere procedura per te mbuluar rezikun qe drejtimi te anashkaloje kontrollet dhe duke bere dallimin mes procedurave qe mund te

zbulojne gabimin por qe nuk jane efektive per te zbuluar mashtrimin. Audituesi pra duhet te ruaje skepticismin profesional, te diskutoje mundesine e mashtrimit me skuadren, te marre kuptuesmeri te procedurave dhe kontroleve qe mundohen te parandalojne apo detektojne mashtrimin, te beje pyetje drejtimit, te ndertoje procedura per te zbuluar mashtrimin ne nivel pohimi dhe pasqyrash financiare, te kuptoje si e mbikqyrin entitetin ata qe jane ngarkuar me qeverisjen e mire dhe te vleresoje edhe nevojat per te komunikuar rastet e mashtrimit te evidentuara ne nivel drejtimi, mbikqyrjeje dhe entesh regullatore. Ne rastin kur shoqeria ka vetem nje pronar atehere hallkat e drejtimit dhe te mbikeqyrjes jane bashke dhe niveli i skepticizmit ndaj mashtrimit duhet te jete me i larte per shkak te mungeses se sistemit te kontrollit.

2. Cili eshte supozimi ne lidhje me rrezikun e mashtrimit ne te ardhurat e nje shoqerie ne sektorin jo-fitimprures ne fazen e planifikimit. (5 pike)

Pergjigje:

Ne baze te SNA-ve audituesi duhet te pergatite dhe zbatoje procedurat duke supozuar qe ekziston reziiku i mashtrimit ne lidhje me njohjen e te ardhurave. Ky supozim duhet te behet ne cdo angazhim. Gjithsesi ekziston mundesia qe ne raste te vecanta ky supozim te mos kete nevojte te behet. Keto raste perfshijne entitete ky e ardhura eshte minimale, si dhe ku elementet e trekendeshit te mashtrimit si mundesia, incentiva dhe racionalizimi nuk jane tipikisht prezente. Nje rast konkret mund te jete sektori jo-fitimprures per sa i perket fondeve te dhuruara nga donatoret. Ne kete rast njohja e te ardhures nuk duket e jete subjekt i manipulimit per shkak te mashtrimit. Gjithsesi, ne kete sektor nese ka te ardhura nga aktivitetet ekonomike, atehere ato duhet te trajtohen duke marre parasysh rrezikun per mashtrim ne njohjen e te ardhures.

3. Cfare nenkuptohet me Persona te Ngarkuar me Qeverisjen ne kuadrin e SNA 260. (4 pike)

Pergjigje:

Personat e ngarkuar me qeverisjen – jane te gjithë personat ose organizatat, (per shembull, administratori i besuar i nje korporate) te cilët kanë pergjegjesine per te mbikqyrur drejtimin strategjik te entitetit dhe detyrimet lidhur me pergjegjshmerine e entitetit. Kjo perfshin mbikqyrjen e procesit te raportimit financiar. Ne disa entitete, personat e ngarkuar me qeverisjen mund te perfshijne edhe personelin drejtues, per shembull, antarët ekzekutive te nje bordi qeverises te entitetit ne sektorin publik ose privat, ose nje pronar-drejtes.

4. **Cfare kerkesash duhet te zbatoje ortaku kryesor i angazhimit për angazhime auditimi, ku percaktohet se duhet te kryhet një rishikim i angazhimit për kontrollin e cilësisë. (5 pike)**

Pergjigje:

Për angazhime të cilat firma ka percaktuar një rishikim të kontrollit të cilësisë është e nevojshme që partneri i angazhimit të:

- (a) Përcaktojë një rishikues i kontrollit të cilësisë angazhimit;
- (b) Diskutojë çështje të rëndësishme që dalin gjatë angazhimit të auditimit, duke përfshirë këtu edhe ato të identifikuar gjatë rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit; dhe
- (c) Vendos datën e raportimit të audituesve vetëm në përfundim të shqyrtimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit.

5. **Përcaktoni anomalitë dhe anomalitë e pakorrigjuara dhe ndikimin e tyre në opinionin e audituesit. Çfarë duhet të mbajë parasysh audituesi para se të vlerësojë efektin e anomalive të pakorrigjuara. (4 pikë)**

Pergjigje:

SNA 450

450.4 a) Anomali: një diferencë midis shumave, klasifikimeve dhe paraqitjes apo shpalesjes të një zëri të raportuar të pasqyrave financiare dhe shumave, klasifikimeve dhe paraqitjes apo shpalesjes së këtij zëri sipas kërkesave të kuadrit të raportimit financiar përkatës. Anomalitë mund të rezultojnë nga gabimi apo mashtrimi.

- b) Anomalitë e pakorrigjuara janë ato anomali që audituesi i ka identifikuar gjatë auditimit të cilat nuk janë korrigjuar në pasqyrat financiare.

450.10 Para se të vlerësojë efektin e anomalive të pakorrigjuara, audituesi duhet të rivlerësojë materialitetin e përcaktuar sipas SNA 320 për të konfirmuar që materialiteti është ende i përshtatshëm.

450.11 Gjithashtu, audituesi duhet të përcaktojë nëse anomalitë e pakorrigjuara janë materiale individualisht ose në total. Për të bërë këtë audituesi merr parasysh:

- a) Madhësinë dhe natyrën e anomalive si në lidhje me klasat e veçanta të transaksioneve, tepricat e llogarive dhe informacionet shpjeguese dhe pasqyrat financiare në tërësi
- b) Efektin e anomalive të pakorrigjuara, në lidhje me periudhat e mëparshme, në klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive dhe informacionet shpjeguese, si dhe pasqyrat financiare në tërësi.

450. 12 Audituesi duhet t'ua komunikojë personave të ngarkuar me qeverisjen anomali të pakorrigjuara dhe efektin që ato individualisht apo në total mund të kenë në opinionin e shprehur në raportin e audituesit. Në këtë komunikim audituesi duhet të identifikojë anomali të materiale të pakorrigjuara dhe të kërkojë korrigjimin e tyre nga entiteti.

6. Jepni përkufizimin e mashtrimit dhe përcaktoni llojet e mashtrimeve që shkaktojnë anomali materiale në pasqyrat financiare. (4 pikë)

Pergjigje:

240.11 Mashtrimi është një veprim i qëllimshëm i kryer nga një apo disa individë në mesin e drejtimit, personave të ngarkuar me qeverisje, punonjësve palëve të treta për të përfituar diçka padrejtësisht apo për të përfituar një avantazh të paligjshëm.

SNA 240.3 Llojet e mashtrimeve që shkaktojnë anomali materiale janë:

1. SNA240.A4 Mashtrimi në raportimin financiar i cili përfshin gabime apo anomali të qëllimshme ose fshehje të shumave apo informacioneve shpjeguese për të mashtruar përdoruesin e pasqyrave financiare. Ky lloj mashtrimi mund të shkaktohet nga përpjekjet e drejtimit për të menaxhuar fitimet për të mashtruar përdoruesit e pasqyrave financiare duke ndikuar në gjykimin e tyre të performancës apo të përfitueshmërisë së entitetit.
2. SNA240.A5 Përvetësim i aktiveve dhe resurseve të entitetit. Ka të bëjë me vjedhjen e aktiveve apo resurseve të një entiteti dhe kryhet nga punonjësit kryesisht dhe për shuma jo materiale. Ky lloj mashtrimi mund të përfshijë edhe drejtimin, i cili ka më tepër mundësi për fshehur përvetësimin duke përdorur mënyra të cilat rezultojnë të vështira për tu identifikuar.

7. Mashtrimi dhe gabimi janë rreziqe të cilat i identifikojmë në shumë entitete. Si audituesit e jashtëm ashtu edhe ata të brendshëm janë të detyruar që të konsiderojnë me këto rreziqe. Megjithatë, përgjegjësia e secilit prej tyre në lidhje me këto rreziqe është e ndryshme. (5 pikë)

Pergjigje:

- I. Përgjegjësia kryesore e audituesit të jashtëm është të japë një opinion për pamjen e vërtetë dhe të drejtë të pasqyrave financiare. Kjo do të thotë se audituesi jep siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.
- II. Skepticizmi profesional. Audituesi i jashtëm është i detyruar të jetë skeptik përgjatë gjithë auditimit duke marrë parasysh mundësinë e anashkalimit të kontrolleve nga

- drejtimi dhe duke pranuar se procedurat e auditimit të cilat janë efektive për të identifikuar gabimet, mund të mos jenë efektive për të zbuluar mashtrimin.
- III. Diskutimet. Skuadra e auditimit është e detyruar që të diskutojë në lidhje me mundësinë që pasqyrat financiare të përmbajnë anomali materiale në saj të mashtrimit apo gabimit.
 - IV. Vlerësimi i rrezikut. Kur krijon njohuri për entitetin, audituesi i jashtëm duhet të marrë në konsideratë të dhëna mashtrimi që mund të rezultojnë në anomali materiale. Kjo përfshin intervista me drejtimin, auditimin e brendshëm dhe procedura analitike. Çdo rrezik anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi do të trajtohet si rrezik i rëndësishëm.
 - V. Reagimi ndaj rreziqeve të vlerësuara. Audituesi i jashtëm duhet të përcaktojë planin e reagimit për të adresuar rrezikun e anomalisë materiale si rezultat i mashtrimit në nivelin e pasqyrave financiare. Kjo përfshin përcaktimin e ekipit të përshtatshëm për të kryer procedurat e auditimit ashtu si dhe mbikëqyrjen e duhur të tyre. Vlerësimin e politikave kontabël të cilat mund të ndikohen më së shumti nga mashtrimi në raportimin financiar dhe të përfshijë procedura të paparashikuara gjatë përzgjedhjes së natyrës, shtrirjes dhe afatit të procedurave të auditimit.
 - VI. Procedura të veçanta të auditimit. Pavarësisht vlerësimit të audituesit në lidhje me rrezikun e anashkalimit të kontrolleve nga drejtimit, audituesi duhet të kryejë procedura për të testuar përshtatshmërinë e regjistrimeve dhe rregullimeve të tjera kontabël.
 - VII. Deklaratat me shkrim të drejtimit. Audituesi i jashtëm duhet të marrë deklarata me shkrim nga drejtimi i entitetit në të cilat drejtimi i entitetit njihë përgjegjësinë e vetë për hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrolleve të brendshme që parandalojnë apo identifikojnë mashtrimin; që i kanë deklaruar audituesit vlerësimin e drejtimit për rrezikun e mashtrimit në pasqyrat financiare; njohurinë e tyre për mashtrimet e dyshuara ose që kanë ndodhur dhe kanë përfshirë drejtimin apo punonjësit me një rol të rëndësishëm në kontrollin e brendshëm.
 - VIII. Kufizimet. Audituesi i jashtëm ka kufizimet e veta të arsyeshme në identifikimin e anomaliave materiale që rezultojnë nga mashtrimi në saj të kufizimeve të auditimit të jashtëm në vetvete si dhe aftësisë së entitetit për të fshehur të dhënat kur ka një bashkëpunim të drejtimit në mashtrim.
 - IX. Raportimi. Në rastet kur audituesi i jashtëm ka identifikuar ose ka dyshime se ka ndodhur një mashtrim, ai duhet ta raportojë këtë gjë në nivelin e përshtatshëm të drejtimit. Në disa rrethana të cilat janë edhe subjekt i legjislacionit, për shembull pastrimi i parave, audituesi duhet të raportojë në organe të jashtme.

8. Përse e përdor audituesi modelin e rrezikut dhe diskutoni veçoritë e modelit duke identifikuar komponentët e tij. (5 pikë)

Pergjigje:

Audituesi e përdor modelin e rrezikut si një mjet për të planifikuar auditimin dhe për të përcaktuar objektivin e procedurave të auditimit për një llogari të veçantë kontabël ose për një kategori të caktuar transaksionesh. Sipas këtij modeli, audituesi është në gjendje të vlerësojë rrezikun e kombinuar apo të anomalisë materiale si të ulët, mesatar apo të lartë. Modeli shprehet si më poshtë:

$$RA = RAM \times RMz$$

$$RAM = RV \times RK, \text{ ku}$$

RA: Rreziku i auditimit, rreziku që audituesi të lëshojë një opinion të gabuar.

RAM: Rreziku që pasqyrat financiare janë të keqparaqitura materialisht para fillimit të punës audituese. Këto rreziqe konsiderohen në nivel të pasqyrave financiare me ndikim në shumë pohime si dhe në nivel pohimi specifik të tepricave të llogarive, klasave të transaksioneve apo shënimet shpjeguese.

RMz: Rreziku i mos-zbulimit është rreziku që audituesi nuk do të zbulojë një anomali që ekziston në një pohim, e cila mund të jetë materiale.

RV: Rreziku i vetvetishëm ose dyshimi që një pohim për një klasë transaksionesh ose tepricë llogarie apo për një informacion shpjegues të dhënë, mund të përmbajë një anomali e cila mund të jetë materiale duke supozuar mungesë të kontrolleve të brendshme

RK: Rreziku i kontrollit ose rreziku që një pohim mund të përmbajë një anomali e cila nuk mund të parandalohet apo zbulohet dhe korrigohet nga kontrolli i brendshëm.

9. Evidenca e auditimit sigurohet në mënyra të ndryshme dhe ka shkallë të ndryshme besueshmerie. Tregoni cilat janë burimet dhe teknikat e grumbullimit të evidencës dhe diskutoni shkallën e besueshmërisë për secilën prej tyre. (4 pike)

Evidencat e auditimit merren gjatë kryerjes së procedurave të auditimit, përmes analizës dhe rishikimit, duke rikryer procedurat e ndjekura gjatë procesit të raportimit financiar dhe duke rakorduar tipe dhe aplikime të informacionit të njëjtë. Nëpërmjet kryerjes së procedurave të auditimit, audituesi mund të përcaktojë se të dhënat e kontabilitetit janë konsistente dhe të njëjta me informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare.

Më shumë siguri merret në rastet kur evidencat e auditimit të marra nga burime të ndryshme janë konsistente me njëra tjetren. Për shembull, informacioni vërtetues i marrë nga një burim i pavarur i subjektit mund të rrisë sigurinë që audituesi merr nëpërmjet evidencave të auditimit, krahasuar me sigurinë e fituar nga inspektimi i informacionit të brendshëm të kompanisë.

Informacione nga burime të pavarura nga subjekti që audituesi mund të përdorë si evidence të auditimit mund të përfshijnë konfirmimet nga palët e treta, raportet e analistëve, dhe të dhëna të krahasueshme në lidhje me konkurrentët (të dhënat sasiorë).

Evidencat e auditimit shërbejnë për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat bazohet opinioni i audituesit. Keto evidence mund të sigurohen gjatë kryerjes së:

(a) procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe

(b) procedurave të mëtejshme të auditimit, të cilat përfshijnë:

(i) Testet e kontrollit, kur kërkohet nga ISA ose kur audituesi ka zgjedhur që ta kryejë këtë procedure, dhe

(ii) procedurat në detaje, duke përfshirë testet në detaje dhe procedurat analitike.

Menyrat e marrjes së evidencave të auditimit gjatë procedurave të vlerësimit të rrezikut apo procedurave në detaje janë si më poshtë;

Inspektimi – përfshin kontrollin e dokumentave, të brendshme apo të jashtme, në formë elektronike ose të printuar, ose kontrolli fizik i aktiveve;

Observimi – konsiston në rishikimin e një procesi apo procedure të kryer nga të tretet;

Konfirmimet nga palët e treta – paraqet një evidence auditimi të siguar nga audituesi gjatë një pyetjeje direkt tek audituesi nga palët e treta;

Perilogaritja – konsiston në kontrollon e saktësisë matematikore të dokumentave dhe regjistrimeve;

Rikryerja - përfshin kryerjen nga ana e audituesit të procedurave dhe kontrolleve që fillimisht ishin kryer si pjesë e kontrollit të brendshëm të kompanisë;

Procedurat analitike - Konsistojnë në vlerësimin e informacionit financiar nepermjet analizës së marrëdhënies mes informacionit financiar dhe atij jo financiar;

Pyetjet – konsiston në marrjen e informacionit nepermjet pyetjeve

Evidencat e auditimit janë më të besueshme në rastet kur

- evidenca është marrë nga palët e treta

- besueshmeria e evidencave të auditimit rritet kur kontrollet përkatëse që lidhen me gjenerimin e këtyre evidencave janë të besueshme

- Dëshmitë e auditimit të marra drejtpërdrejt nga audituesi (për shembull, vëzhgimi i zbatimit të një kontrolli) është më i besueshëm se evidenca e auditimit të marra në mënyrë të tërthortë (për shembull, vëzhgimet në lidhje me aplikimin e një kontrolli).

Evidencat e auditimit të marra në formë dokumentare, qoftë të printuara apo elektronike, apo të tjera, është më i besueshëm se prova të marra verbalisht

Evidencat e auditimit të mbështetura me dokumentet origjinale janë më të besueshme se dëshmitë e auditimit të marra nga fotokopje ose fakse, ose dokumente që janë skanuar modifikuar në formë elektronike.

10. Pse standardet e auditimit preferojnë konfirmimet nga palët e treta si evidencë auditimi dhe cilat janë llojet e konfirmimeve që parashikon SNA. (4 pike)

Pergjigje:

Një konfirmim nga palët e treta paraqet evidencë auditimi të marra nga audituesi si një përgjigje të drejtpërdrejtë me shkrim drejtuar audituesit nga një palë e tretë, që konfirmon në formë të shkruar ose elektronike.

Sipas SNA 500 besueshmëria e evidencave të auditimit është e ndikuar nga burimi i saj dhe nga natyra e saj, dhe varet nga rrethanat individuale në të cilat ajo është marre. Kjo SNA gjithashtu përfshin përgjithësimet e mëposhtme të aplikueshme për evidencat e auditimit.

- Evidenca e auditimit është më e besueshme kur ajo është marrë nga burime të pavarura jashtë subjektit.
- Evidenca e auditimit që merret direkt nga audituesi është më e besueshme se sa evidencat e auditimit të marra në mënyrë të tërthortë ose me nderhyrje.
- Evidenca e auditimit është më e besueshme kur ajo ekziston në formë formale qoftë të shkruar, elektronike apo në mënyrë të tjera. Për pasojë, varësisht nga rrethanat e auditimit, evidenca e auditimit në formën e konfirmimeve të paleve të treta të marra direkt nga audituesi mund të jetë më i besueshëm se provat e gjeneruara nga brenda njësisë ekonomike. Ky SNA ka për qëllim për të ndihmuar audituesin në hartimin dhe kryerjen e procedurave të konfirmimit të jashtëm për të marrë prova relevante dhe të besueshme të auditimit.

SNA-të tjera njohin rëndësinë e konfirmimeve të jashtëm si evidence e auditimit

Sipas SNA 505 dy janë llojet e konfirmimeve

Konfirmime pozitive - Një kërkesë sipas së ciles, pala që i është kërkuar konfirmimi, i përgjigjet direkt audituesit duke specifikuar nëse dakordon apo jo me informacionin e paraqitur në konfirmim ose i dërgon informacionin e kërkuar nga audituesi.

Konfirmime negative - Një kërkesë sipas se ciles pala që i është derguar konfirmimi i përgjigjet direkt audituesit vetëm nëse ajo nuk dakordon me informacionin e dhënë në leter konfirmim.

11. Gjatë auditimit të vlerësimeve kontabël supozimet e përdorura nga drejtimi i kompanisë janë një element integral. Përshkruani çështjet që audituesi duhet të konsiderojë gjatë konsiderimit të supozimeve të përdorura nga drejtuesit (5 pikë)

Pergjigje:

Vlerësimi nga ana e audituesit të supozimeve të përdorura nga drejtimi është i bazuar vetëm në informacionin që i është vënë në dispozicion audituesit në kohën e auditimit. Procedurat e auditimit që kanë të bëjnë me supozimet e drejtimit janë kryer në kontekst të auditimit të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike, dhe jo me qëllim të sigurimit të një opinionimi mbi vetë supozimet.

Çështjet që audituesi mund të marrin në konsideratë në vlerësimin e arsyeshmërisë së supozimeve të përdorura nga drejtimi përfshijnë, për shembull:

- nëse supozime individuale duken të arsyeshme;
- Nëse supozimet janë të ndërvarura dhe konsistente;
- Nëse supozimet duken të arsyeshme kur konsiderohet kolektivisht ose në lidhje me supozimet e tjera, qoftë për këtë vlerësim kontabël ose për vlerësimet e tjera kontabel;

Supozimet mbi të cilat bazohen vlerësimet kontabel mund të pasqyrojnë atë çfarë drejtimi pret që të jetë rezultati i objektivave dhe strategjive specifike. Në raste të tilla, audituesi mund të kryejë procedurat e auditimit për të vlerësuar arsyeshmërinë e supozimeve të tilla duke marrë parasysh, për shembull,

- nëse supozimet janë në përputhje me: mjedisin e përgjithshëm ekonomik dhe rrethanat ekonomike të njësisë ekonomike
- Planet e subjektit.
- Supozimet e bëra në periudhat e mëparshme, kur është e nevojshme.
- Përvoja e, ose kushtet e mëparshme të njësisë ekonomike, në masën kur ky informacion historik mund të konsiderohet si përfaqësues i kushteve apo ngjarjeve të ardhshme;
- Supozimet e tjera të përdorura nga drejtimi në lidhje me pasqyrat financiare.

Arsyeshmëria e supozimeve të përdorura mund të varet nga qëllimi i drejtimit dhe aftësisë së tyre për të ndermarre disa veprime. Drejtimi shpesh i dokumenton planet dhe qëllimet për klasat përkatëse të aktiveve ose pasiveve dhe stansardet e raportimit financiar mund t'i kërkojë një gjë të tillë. Edhe pse shkalla e evidencave të auditimit që duhet të merren në lidhje me qëllimin e drejtimit dhe aftësisë është një çështje e gjykimit profesional, procedurat e audituesit duhet të përfshijnë si në vijim:

- Rishikimi i historikut të veprimeve të marra nga drejtimi për të arritur qëllimet e tij;

- Rishikimi i planeve të shkruara dhe dokumente të tjera, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, buxhetet e miratuara zyrtarisht, autorizimeve ose minuta të takimeve.
- Diskutime me drejtimin në lidhje me arsyet e tyre për veprimet e ndermarra;
- Shqyrtimi i ngjarjeve që ndodhin pas datës së pasqyrave financiare dhe deri në datën e raportit të audituesit.
- Vlerësimi i aftësisë së drejtuesve të njësisë ekonomike për të ndermarre veprime të caktuara bazuar në rrethanat ekonomike të njësisë ekonomike, duke përfshirë implikimet e angazhimeve të tyre ekzistues.

12. Kompania Delta ka 5 vite që operon me humbje dhe ka një fluks paraje operacional negativ. Kompania mëmë nuk konfirmon që do të vazhdojë ta mbështesë financiarisht kompaninë Beta. Ju si auditues i kompanisë keni gjykuar që parimi i vijimësisë nuk është përdorur saktë nga drejtimi dhe një pasiguri materiale ekziston. Cilat janë hapat që duhet të ndërmerreni juve si auditues dhe si adresohet situata e mësipërme në raportin e audituesit? (5 pikë)

Pergjigje:

Situata e mësipërme paraqet rastin kur audituesi ka gjykuar që supozimet e përdorura nga drejtimi lidhur me vijimesinë e biznesit është e pasakte, kjo bazuar në evidencat e auditimit të marra. Në këtë kusht audituesi duhet të komunikojë me palet e ngarkuara me qeverisjen dhe të kuptojë planet e tyre dhe arsyet se pse ato kanë supozuar që parimi i vijimesisë është i aplikueshem. Në varesi të argumenteve të marra nga drejtimi, kemi situatat e mëposhtme

- Në rast se audituesi bindet që pasiguria është materiale, por parimi i vijimesisë është i sakte, atëherë audituesi i kërkon drejtimin që në shenimet e pasqyrave financiare të shprehet për planet që ka drejtimi për të adresuar pasigurinë materiale për vijimesinë e kompanisë. Në rast se drejtimi pranon të bëjë këto shënime në pasqyrat financiare, audituesi shprehet për pasigurinë materiale në paragrafin “çështje për theksim” të raportit të audituesit. Në rast se drejtimi nuk pranon të bëjë paraqitjet e duhura në pasqyrat financiare, atëherë audituesi leshon një opinion të kundërt ose refuzim për dhenie opinion;
- Në rast se audituesi bindet që pasiguria është materiale dhe parimi i vijimesisë nuk është i sakte dhe drejtimi nuk dakordon me audituesin atëherë audituesi leshon një opinion të kundërt;

13. Cfare eshte nje kuadër me qellim specifik? Jepni 2-3 shembuj (4 pike)

Pergjigje:

Sipas SNA 800 “Konsiderata te vecanta- Auditimet e pasqyrave financiare te përgatitura sipas kuadrove per qëllime specifike”, me kuadër me qellim specifik do te kuptojmë nje kuadër raportimi financiar te projektuar per te përmbushur nevojat per informacion financiar te përdoruesve specifike (**1 pike**). Kuadri i raportimit financiar mund te jete nje kuadër i paraqitjes se drejte (**1 pike**). ose nje kuadër i pajtueshmërisë (**1 pike**). Shembuj te kuadrove per qëllime specifike përfshijnë sa me poshtë:

- Nje baze e kontabilitetit tatimor per nje sere pasqyrash financiare qe shoqërojnë deklarimin tatimor te nje entiteti (**0.5 pike**).
- Baza kontabël e arkëtimeve dhe disbursimeve qe entiteti mund ta paerdore per te përgatitur informacionet per flukset e parasë qe entitetit mund ti kërkohet te pergatitet nga ana e kreditorëve (**0.5 pike**).
- Dispozitat e raportimit financiar te vendosura nga nje rregullator per te përmbushur kërkesat e këtij rregullatori (**0.5 pike**).
- Dispozitat e raportimit financiar te nje kontrate te tilla si nje kontrate, nje marreveshje e kredisë apo nje prjekt i grantit. (**0.5 pike**).

14. Shpjegoni shkurtimisht se çfarë përmban paragrafi i përgjegjësi se audituesit ne nje raport auditimi. Nga ndryshon ai nga paragrafi i përgjegjësisë se drejtimit ne raportin e auditimit? (4 pike)

Pergjigje:

Paragrafi i përgjegjësisë se audituesit ne nje raport auditimi përmban përgjegjësinë e audituesit per te shprehur opinionin e tij ndaj pasqyrave financiare. Permban bazen rregullatore te audituesit sipas **Standardeve Nderkombetare te Auditimit** si edhe faktin qe këto standarde kërkojnë zbatueshmërinë e **kërkesave etike**. Ne kete paragraf përshkruhet qe audituesi ka përgjegjësinë per te shprehur siguri te arsyeshme dhe jo absolute. (**1 pike**) Se fundmi ne kete paragraf përshkruhet shkurtimisht kryerja e procedurave te audituesit per te marre sigurinë e arsyeshme, faktin qe bazohet ne sistemin e kontrollit te brendshëm si edhe vlerësimin e e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. (**1 pike**). Paragrafi i përgjegjësisë se audituesit ne nje raport auditimit ndryshon nga paragrafi i përgjegjësisë se drejtimit per arsye se ne kete fundit theksohet se përgjegjësia per përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare i takon drejtimit. (**1 pike**) Si edhe drejtimi eshte përgjegjës per hartimin e sistemit te kontrollit te brendshëm qe për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofshin për shkak të mashtrimit apo gabimit. (**1 pike**)

15. Kompania ABC sh.p.k. po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2015. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje më SNRF dhe kompania nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Pasqyrat financiare përfshijnë: Bilancin Kontabël, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në Kapital

dhe Pasqyrën e Lëvizjes së Flukseve Monetare. Audituesit e jashtëm kërkohet që të raportojnë për pronarët e kompanisë për vitin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2015. Marrëveshjet e financimit të ABC sh.p.k. përfundojnë më 17 Mars 2016, si dhe detyrimet e papaguara duhet të shlyhen në këtë datë (deri në tre muaj pas përfundimit të vitit financiar). Deri në datën e nënshkrimit të raportit të auditimit, kompania nuk ka qenë në gjendje të ri-negociojë marrëveshjet ose të përfitojë financim shtesë. Kjo situatë tregon ekzistencën e një pasigurie materiale, e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme për aftësinë e kompanisë për të aplikuar pariminin e vijimësisë së biznesit. Kompania nuk do të ishte e aftë të realizonte aktivet e saj dhe të paguante detyrimet sipas aktivitetit normal të saj. Drejtimi nuk i ka paraqitur këto fakte në pasqyrat financiare sic kërkohet nga paragrafi 25 i IAS 1, “Paraqitja e pasqyrave financiare”. Detyrimi është klasifikuar dhe paraqitur si detyrim afatshkurtër, në përputhje me paragrafin 69 të IAS 1. Materialiteti i audituesve i percaktuar është për 31 Dhjetor 2015 është 10 mln Leke. Totali i aktiveve në Bilanc për 31 Dhjetor 2015 janë 125 mln leke ndërsa në 31 Dhjetor 2014 janë 150 mln leke.

Pyetje: Percaktoni se çfarë tipi opinionit do të leshojnë audituesit drejtimit? Çfarë do të shkruhet në paragrafin e tyre të raportit të auditimit? **(5 pike)**

Pergjigje:

Zgjidhje: Tipi i opinionit që do të leshohet do të jetë Opinioni me rezerve **(1 pike)**

Baza për opinionin me rezervë:

Marrëveshjet e financimit të ABC shpk përfundojnë më 17 Mars 2016, si dhe detyrimet e papaguara duhet të shlyhen në këtë datë. Kompania nuk ka qenë në gjendje të ri-negociojë marrëveshjet ose të përfitojë financim shtesë. Kjo situatë tregon ekzistencën e një pasigurie materiale, e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme për aftësinë e kompanisë për të aplikuar pariminin e vijimësisë së biznesit **(1 pike)** dhe, rrjedhimisht, kompania mund të jetë e paaftë të realizojë aktivet e saj dhe të paguajë detyrimet sipas aktivitetit normal të saj. Në kundërshtim me IAS 1, ‘Paraqitja e pasqyrave financiare’, drejtimi nuk i ka paraqitur këto fakte në pasqyrat financiare të bashkëngjitura. **(1 pike)**

Opinionit me rezervë:

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çeshtjes së përshkruar në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, **(1 pike)** pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjithë aspektet, të pozicionit financiar të ABC sh.p.k. në datën 31 Dhjetor 2015, të performancës financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar **(1 pike)**.

16. Kompania ABC sh.p.k. po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2015. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me SNRF dhe kompania nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Pasqyrat financiare përfshijnë: Bilancin Kontabël, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në Kapital dhe Pasqyrën e Lëvizjes së Flukseve Monetare. Audituesit e jashtëm u kërkohet që të

raportojnë për pronarët e kompanisë për vitin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2015. Audituesit janë emëruar gjatë vitit 2015 dhe, si rezultat, nuk kanë marrë pjesë në numërimin fizik të inventarit më 31 Dhjetor 2014. Ekzistenca e inventarit në këtë datë nuk mund të auditohet duke përdorur procedura alternative auditimi. Drejtimi i kompanisë vlerëson se ka vetëm një segment operativ. Megjithatë, bazuar në evidencën e auditimit, audituesit kanë arritur në përfundimin se kompania ka dy segmente operative, të cilët janë të raportueshëm (sic parashikohet në paragrafin 11 të SNRF 8 ‘Segmentet operative’). Dy segmentet operative janë shitja e qumështit dhe prodhimi i djathit. Materialiteti i audituesve i percaktuar për 31 Dhjetor 2015, është 10 mln Leke. Inventari në Bilanc për 31 Dhjetor 2015 është 12 mln leke ndërsa në 31 Dhjetor 2014 është 7 mln leke.

Pyetje: Përcaktoni se çfarë lloji opiniononi do t’i leshojne audituesit drejtimit? Përgatisni një ekstrakt ku të të përmbaje paragrafin e opinionit të raportit të auditimit? **(5 pike)**

Përgjigje:

Tipi i opinionit që do të leshohet është opinion me rezervë. **(1 pike)**

Baza për opinionin me rezervë:

Mospjesëmarrja në numërimin e inventarit

Ne u kontraktuam si auditues të jashtëm nga kompania gjatë vitit dhe për këtë arsye nuk kemi observuar numërimin e inventarit fizik në fillim të vitit. Ne nuk arritëm të siguronim të dhëna alternative për të vërtetuar sasinë e inventarit të mbajtur më 31 Dhjetor 2015. Meqenëse vlera hapëse e inventarit përfshihet në përcaktimin e performancës financiare dhe të flukseve monetare, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të ishte i nevojshëm ndonjë korigjim në lidhje me fitimin e vitit të raportuar në pasqyrën e të ardhurave dhe në flukset monetare nga aktiviteti operativ të raportuar në pasqyrën e flukseve monetare **(1 pike)**.

Segmentet operative

Ashtu sic përshkruhet në Shënimin Shpjegues 1, pasqyrat financiare të kompanisë ABC sh.p.k. janë përgatitur në bazë të një segmenti operativ. Në këtë mënyrë, ato nuk përfshijnë informacionin e segmentuar sipas paragrafëve 22-24 të SNRF 8 ‘Segmentet operative’. Bazuar në evidencën e auditimit, ne jemi të opinionit që dy linjat e biznesit të kompanisë përbëjnë segmente të ndara operative dhe janë të raportueshëm në përputhje me SNRF 8. **(1 pike)**.

Opinionin me rezervë:

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çeshtjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjithë aspektet, të pozicionit financiar të ABC shpk në datën 31 Dhjetor 2015, të performancës financiare dhe flukset e pasasë për vitin e mbyllur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. **(1 pike)**.

.....

Suksese!